

VEVENDITJE E DREJTËSI
REPUBLIKË E KOSOVËS
VEVENDITJE E DREJTËSI
REPUBLIKË E KOSOVËS
GJYKATA E FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

08.11.2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-

Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Elmaz Zenuni dhe me sekretaren juridike Razije Beqiri, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 285 par. 2 të KPK-së, sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Publike Komonale në Ferizaj PP Nr.1299-05/2012 të dt. 29.08.2012 në shqyrtimin e hapur gjyqësor të mbajtur me datën 21.09.2015, në praninë e Prokurorit të shtetit Rafet Halimi, përfaqësuesit të dëmturës DBP - zyra në në Ferizaj Xhevdet Ramolli, të akuzuarit e dëshmitarëve, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e [REDAKTUAR], i lindur me [REDAKTUAR], në të njëjtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i martuar baba i 6 fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, shqitpar shtetas i Kosovës, i denuar më parë për vepra të njejta penale,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 18.07.2012 rreth orës 12,30 në pyllin publik të cilin e menaxhon Drejtoria për bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-zyra në Ferizaj, në Rajonin Eonomiko-PyJOR në fshatin Neredime-Jezerc në vendin e quajtur "Paralelja 29 Jezerci" me qëllim vjedhjeje me sharrë motorike ka prerë 10 copë dru ahu të njomë, me gjatësi 25 metra me diametër 26-42 cm., në vëllim 11.25 m3 dhe në vlerë prej 1518.75 €.

me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 285 par.2 të KPK-së.

Gjykata në kuptim të nenit 285 par.2 të KPK-së, dhe nenit 3.11, 34.38, 39, dhe 64 të KPK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, e

G J Y K O N

Me dënim në të holla në shumë prej 900 /nëndqind / Euro, të cilat është i obliguar që ti paguaj në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyrat tjera të parapara nga nenin 39 par.3 të KPK-së, gjykata do ta ekzekutoj aktgjykimin në atë mënyrë që të pandehurit për çdo 15 € të gjobës të vuaj në një ditë burgu.

Obligohet i pandehuri që të damtuarit- DBP zyra në Ferizaj në emër të kërkesës pasuroro-juridike të i bëjë kompensimin e dëmit në lartësi prej 1518.75 €.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqsor të paguaj kësaj gjykate shumë prej 20 /njëzetë/ Euro, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së katgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Isn Prokuroria Publike Komonale në Ferizaj ka ushtruar aktakuzën e vet PP nr.1299-05/2012 të dt. 09.09.2012, kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 285 par.2 të KPK-së.

Gjykata, duke vepruar sipas akuzës së PPK-së në Ferizaj më datën 21.09.2015 ka mbajtur shqyrtimin gjyqsor në të cilën Prokurori i shtetit Rafet Halimi si në fjalën hyrëse, por edhe ate përfundimtare deklaroi: se ngel në tërësi pranë propozim akuzës, i propozoj gjykatës që të nxjerrë provat e propozuara në propozim akuzë, dhe pas vlersimit të tyre i akzuari të shpallet fajtor dhe të i shqiptohet dënimi i parapar me ligj.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqsor delarohj: se nuk e ndin vehtën fajtor për veprën penale e cila i vehet në barrë, pra për veprën penale vjedhje pylli nga neni 285 par.2 të KPK-së dhe shton se personalisht nuk e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata, pasi që ka dëgjuar fjalën hyrëse të prokurorit të shtetit i cili në shqyrtim gjyqsor ka theksuar se do të vërtetohen faktet e veprës penale të vjedhjes për të pandehurin Sabit Hyseni, ku e dëmtuara është DBP- zyra në Ferizaj, e kjo do të vërtetohet në bazë të dëshmisë së dëshmitarëve : [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që të dy roje pylli në DBP- zyra në Ferizaj -si dhe provat tjera të cilat gjinden në lëndë.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës DBP-zyra në Ferizaj Xhevdet Ramolli, ka përkrahur në tërësi fjalën hyrëse të Prokurorit të shtetit sa i përket përgjegjësisë penale të pandehurit, kurse sa i përket kërkesës pasuroro – juridike ka paraqitur kërkesë për kompensimin e dëmit në lartësinë e shumës të cekur në propozimakuze të PPK-së në Ferizaj në shumën prej 1518.75 Euro.

Gjykata bëri zbatimin e provave: dëgjoj dëshmitarin – roje e pyllit pranë DBP- zyra në Ferizaj, [REDAKTUAR]-roje pylli, i cili është edhe hartues i Procesverbalit i cili është provë përcaktuese në lëndën juridike dhe në shqyrtim gjyqsori cili deklaroi se : është e vërtet se të pandehurin [REDAKTUAR] më dt. 18.07.2012 rreth orës 12,30 e kam hasur personalisht në vendin e quajtur “Paralelja nr.29 Jezerci” në pyllin shoqëror të APK në Ferizaj, pikërtishtë në fshatin Jezerc duke bartur me traktor IMT-539 me krrabë dhe ate10 copa dru të ahut të njomë, të cilin më parë e kishte prerë me sharrë motorike me gjatësi prej 25 m., me diametër 26-42 cm, dhe unë të pandehurin e kam parë personalisht së bashku me kolegët e mijë si [REDAKTUAR] etj. në vendin e ngjarjes, ndërkaq sasinë dhe vlerën e dëmit e ka caktuar Tekniku i pylltarisë dhe kjo është e vërtet se i njejt ditën kritike e ka dëmtuar pyllin shoqëror ashtu siq është paraqitur në fletëparaqitjen e rojës së pyllit, përfundon dëshminë e tij dëshmitari.

Gjykata dëgjoj edhe dëshmitarin [REDACTED] – roje e pyllit pranë DBP- zyra në Ferizaj, i cili në shqyrtimin gjyqësor njësoi sikurse edhe dëshmitari i parë deklaroi se unë kam qenë së bashku me [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] të gjithë roje pylli në APK –Zyra në Ferizaj, dhe është e vërtet se të pandehurin [REDACTED] më dt. 18.07.2012 rreth orës 12,30 e kemi hasur personalisht,por edhe me kolegët e mij të sipërcekur në vendin e quajtur “Paralelja nr.29 Jezerci” në pyllin shoqëror të APK në Ferizaj, pikërtisht në fshatin Jezerc duke bartur me traktor IMT-539 me krrabë dhe ate10 copa dru të ahut të njomë, të cilin më parë e kishte prerë me sharrë motorike me gjatësi prej 25 m., me diametër 26-42 cm, dhe edhe njëherë theksoj se unë të pandehurin e kam parë personalisht së bashku me kolegët e mijë në vendin e ngjarjes, ndërkaq sasinë dhe vlerën e dëmit e ka caktuar Tekniku i pylltarisë dhe kjo është e vërtet se i njëjti ditën kritike e ka dëmtuar pyllin shoqëror ashtu siq është paraqitur në fletëparaqitjen e rojës së pyllit, përfundon dëshminë e tij dëshmitari.

Përfaqësuesi juridik i të dëmtuarës DBP- zyra në Ferizaj në emër të kërkesës pasuroro – juridike ka kërkuar kompensimin e dëmit në shumën prej 1518.75 €

Gjykata, ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njërën me tjetrën, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi dhe ka konstatuar : me datën 18.07.2012 rreth orës 12,30 në pyllin publik të cilin e menaxhon Drejtoria për bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-zyra në Ferizaj, në Rajonin Ekonomiko-Pyjetor në fshatin Noredime-Jezerc në vendin e quajtur “Paralelja 29 Jezerci” me qëllim vjedhjeje me sharrë motorike ka prerë 10 copë dru ahut të njomë, me gjatësi 25 metra me diametër 26-42 cm., në vëllim 11.25 m³ dhe në vlerë prej 1518.75 €.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë: vlerësimi dhe llogaritja e dëmit të pyllit nga fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, zyra në Ferizaj si dhe procesverbali me nr. 379/2012 i dt. 20.07.2012 , dhe Procesverbali i dëmit të shkaktuar me numër dhe datë të njëjtë, të gjitha këto janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

Duke vërtetuar gjendjen faktike gjykata konfirmon se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet qensore të veprës penale vjedhje pylli nga neni 285 par.2 të KPK-së, andaj, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe në kuptim të dispozitave ligjore të cituara në dispozitiv të aktgjykimit i shqiptoj dënim në të holla në shumën prej 900 Euro, i cili është i obliguar që dënimin e shqiptuar në të holla ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmëris së akgjykimit.

Gjykata çmoj dhe vlersoj mbrojtjen e të akuzuarit se kinëse ai personalisht nuk ka ndërmarr veprimin e dëmtimit të pyllit, dhe se në këtë bazë kinëse nuk ekziston fajësia, pasi që nuk është provuar se ka kryer veprën penale dhe se nga pylltarët është zënë në rrugë, e jo në pyll, dhe se drutë nuk kanë qenë të njoma dhe se ai personalisht nuk i ka prerë, por i ka gjetur të prera në pyll.

Gjykata tezën mbrojtëse të propozuar nga i pandehurit nuk e ka pranuar si të bazuar nga pohimet e tij dhe se Procesverbali i hartuar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural zyra në Ferizaj, është provë e pranueshme, por edhe Procesverbali i dëmit të shkaktuar me numër dhe datë të njejtë, por edhe deklaratat e dëshmitarëve në tërësi e vërtetojnë gjendjen faktike e paraqitur në akuzë, kurse mbrojtjen e pandehuri e ka bërë me qëllim të shmangëjes nga përgjegjësia penale duke i kundërshtuar deklaratat e dhëna nga ana e dëshmitarëve.

Gjatë shqiptimit të dënimin në kuptim të nenit 64 të KPK-së gjykata pati parasysht rrethanat lehtësuese dhe randuese, si rrethana lehtësuese gjykata pati parasysht faktin se i akuzuari është i pa punë, baba i gjashtë fëmijëve, dhe i gjendjes së varfër ekonomike.

Si rrethana tjera rënduese gjykata pati parasysht shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer, e ato janë: *se është recidivist i këtyre llojeve të veprave penale dhe i dënuar edhe më parë me akjtgjykim të formës së prerë nga ana e kësaj gjykate dhe se ka edhe procedura tjera penale për të njejtat vepra penale në këtë gjykatë.*

Ndërsa, rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoj një dënim me gjobë duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale duke i caktuar dënim me gjobë të paraparë me neniin 39 par.4 të KPK-së, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi ndëshkues në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale të paraparë me neniin 34 të KPK-së.

Konform neniin 458-463 të KPPK-së obligohet i akuzuari që DBP-Zrya në Ferizaj në Ferizaj në emër të kërkesës pasurore – juridike të i kopmensoj dënimin e shkaktuar në shumën prej 1518.75 €

Konform neniin 454 par.1 të KPPK-së i akuzuari obligohet në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqsor të paguaj kësaj gjykate shumën prej 20 /njëzet/ Euro, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së katgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipërcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

P.nr.1657/12 të dt. 21.09.2015.

Sek.juridike,
Razije Beqiri

Gjyqtari

Elmaz Zenuni



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 dite, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

Ankesa dorzohet nëpërmes kësaj gjykate.

copy në dt 22 09 15
1 x Pih
1 x të cilës
1 x të dëmt. PFB